



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:211894 **C. nr. 2003/2021**
Datë: 13.12.2022
Numri i dokumentit: 03746235

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Hilmi Elshani, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësve: M.C., M.L., M.B., M.Z. dhe M.Ş., që të gjithë nga Prizreni, të cilën me autorizim i përfaqëson avokati A.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale në Prizren, për kompensimin e shujtave ditore, jashtë seance, me datë 13 Dhjetor 2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M
(pa shqyrtim kryesor)

MIRATOHET, si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: M.C., M.L., M.B., M.Z. dhe M.Ş., që të gjithë nga Prizreni, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që të i' a paguan paditësve: M.C. shumën 370.00 €, M.L. shumën 370.00 €, M.B. shumën 370.00 €, M.Z. shumën 370.00 € dhe M.Ş. shumën 370.00 €. Si dhe t'i kompenzon shpenzimet e procedurës në shumën 342,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi kundër Komunës së Prizrenit – Drejtorisë Komunale në Prizren, me të cilën ka kërkuar që në emër të shujtave ditore të paguhet për vitin 2019. Sipas të autorizuarit të paditësve të njëjtit kanë qenë në marrëdhënie pune në vitin 2019 dhe se nuk janë paguar shujtat ditore në lartësi prej dy euro në ditë nga e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale në Prizren, duke u bazuar në neni 35 par.7 të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, edhe pse janë bërë përpjekje që t'i realizohet e drejta e tyre lidhur me realizimin e pagesës së shujtave për vitin 2019, por përpjekja e tyre ka rezultuar pa sukses.

Paditësit i kanë bashkangjitur provat materiale vërtetimin për ditët e pranisë në punë të lëshuara nga SH.F.M.U. “Motrat Qiriazhi” në Prizren.

Nga theksimet e paraqitura në padi theksohet se paditësit janë në marrëdhënie pune në SH.F.M.U. “Motrat Qiriazhi” në Prizren, dhe se nuk janë paguar shujtat ditore në lartësi prej 2 (dy) euro në ditë. Në bazë vërtetimeve të ditëve të punës të lëshuar nga SH.F.M.U. “Motrat Qiriazhi” në Prizren, për paditësit, gjatë vitit 2019, kanë këto ditë pune të pa paguara, dhe atë për vitin 2019, kanë 185 ditë pune, nga dy euro në ditë, në shumën e prej 370 euro, secili veç e veç.

Ka propozuar miratimin e kërkesëpadisë. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës sa do që bëhen deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje.

Pala e paditur në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se paditësi është thirrur në dispozitat nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, pa dëshmuar se është anëtare të Sindikatës së Arsimit të Kosovës – SBASHK.

Po ashtu nuk kanë paraqitur prova tjera për shterjen e gjitha mjeteve juridike, që kanë kaluar në procedurën administrative, sepse nuk kanë ushtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, por janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par.6.1 të Ligjit të Përgjithshme Administrative nr.05/031, ku Komunës së Prizrenit me këto veprime i shkaktojnë shpenzime të mëdha.

Gjithashtu, sipas tyre Qeveria e Kosovës është garantuese për implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe se Ministria e Arsimit është dashur të fillon realizimin e të drejtave që dalin nga KKAK, duke planifikuar buxhet në bashkërendim me Ministrinë e Financave, po e cila nuk e ka caktuar kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kontrata Kolektive, ashtu që Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk mund të vepron në kundërshtim me ligjin për Buxhet, sa i përket tejkalimeve buxhetore të planifikuara për vitin 2022.

Si dhe sipas tyre marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Andaj, bazuar në këto fakte, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit të refuzon, në tërësi si të pabazuar.

Gjykata gjatë ekzaminimit të shkresave të lëndës dhe vërtetimeve të lëshuara nga SH.F.M.U. “Motrat Qiriazit” në Prizren, vërtetohet se paditësja M.C. gjithsejte ka pasur 185 ditë pune aktive, gjatë vitit 2019, paditësja M.L. gjithsejte ka pasur 185 ditë pune aktive, gjatë vitit 2019, paditësja M.B. gjithsejte ka pasur 185 ditë pune aktive, gjatë vitit 2019, paditësja M.Z. gjithsejte ka pasur 185 ditë pune aktive, gjatë vitit 2019, dhe paditësja M.Ş. gjithsejte ka pasur 185 ditë pune aktive, gjatë vitit 2019.

Në kuptim të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, punëtorëve të arsimit ju njihet e drejta në kompensim të shpenzimeve të ushqimit në punë për një ditë pune të pranishme në punë në shumën 2.00 €, me kusht që punëdhënësi të mos ketë të organizuar përmes restorantit apo kuzhinës në vendin e punës.

Në rastin konkretë paditësja M.C. është vërtetuar se, gjatë vitit 2019, ka qenë e pranishme në punë 185 ditë me punë aktive, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 185 ditë, gjithsejte ka të drejtën të kompensohet në shumën prej 370 €, paditësja M.L. është vërtetuar se, gjatë vitit 2019, ka qenë e pranishme në punë 185 ditë me punë aktive, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 185 ditë, gjithsejte ka të drejtën të kompensohet në shumën prej 370 €, paditësja M.B. është vërtetuar se, gjatë vitit 2019, ka qenë e pranishme në punë 185 ditë me punë aktive, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 185 ditë, gjithsejte ka të drejtën të kompensohet në shumën prej 370 €, paditësja M.Z. është vërtetuar se, gjatë vitit 2019, ka qenë e pranishme në punë 185 ditë me punë aktive, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 185 ditë, gjithsejte ka të drejtën të kompensohet në shumën prej 370 € dhe paditësja M.Ş. është vërtetuar se, gjatë vitit 2019, ka qenë e pranishme në punë 185 ditë, me punë aktive, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 185 ditë, gjithsejte ka të drejtën të kompensohet në shumën prej 370 €.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017.

Gjykata konkretisht u bazua në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilën parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë*

punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit apo kuzhinës, ose një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”. Së këndejmi, rezulton se punëdhënësi i gjithë paditësve është e paditura në këtë rast, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me seli në Prishtinë. Ndërsa, sipas nenit 2 par. 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë shprehimisht precizohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”. Ndërsa, sipas par. 2 të këtij neni theksohet që “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.

Po ashtu, me rastin e vendosjes sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata pati parasysh edhe nenin 90 par. 5 të LP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore theksohet që “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënësi dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Rrjedhimisht, edhe sipas kësaj dispozite ligjore, detyrimi për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë (shujtës ditore) i takon punëdhënësit të paditësve, respektivisht të paditurës. Ndërsa në nenet e përmendur më lartë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit që në rastin konkret rezulton të jetë e paditura, t’ia kompensoj ushqimin në punë dhe detyrohet për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj paditësve, që dalin nga kjo kontratë kolektive.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve janë të themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Për shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, pasi që pala e paditur ka humbur, ashtu që detyrohet pala e paditur që palëve paditëse t’ia paguaj në emër të përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 € dhe në emër të takës gjyqësore në shumën prej 30.00 €, gjithsejtë në shumën prej 342.00 €.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
C. nr. 2003/2021 datë 13 Dhjetor 2022

B. profesional
Hilmi Elshani

Gj y k a t e s i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.